

PËRMBYTJET

Kryebashkiaku Mziu me kryetarin e PD-së, Basha, vizituan familjet e përmbytura në Kamëz



FAQE 5

SHËRBIME

Takim me përfaqësues të KfW për fillimin e fazës 3-4 të ujësjellësit të Kamzës



FAQE 8

NDIHMJA

Bashkëpunim i Bashkisë me fondacione të ndryshme për të qenë sa më pranë qytetarëve



FAQE 7

INVESTIME

Vijon puna e Bashkisë për lirim e hapësirave publike për të ndërtuar rrugë në dobi të komunitetit



FAQE 8



Gazetë e Bashkisë Kamëz

KAMZA

E përdyjavshme
 Nr. 209 Dhjetor 2017
 Çmimi 20 lekë
 drmediakamez@gmail.com
 www.kamza.gov.al

Raporti përmbledhës i Ministrisë së Financave për njësitë vendore

Kamza, Bashkia me performancën më të mirë financiare sipas Ministrisë së Financave

FAQE 2

Kryebashkiaku Xhelal Mziu për gazetën "Koha Jonë": Rama të reflektojë për Kamzën

Faqe 3

Kryebashkiaku Mziu për "Tonight": Në Kamëz u përmbytën 635 familje, situata do përsëritet nëse qeveria nuk financon projektet

Faqe 6

Parandalimi i përmbytjeve, Xhelal Mziu: Ja kërkesat që i parashtrova Ramës

Faqe 6

Bashkëpunim me Ambasadën Turke në ndihmë të familjeve në Valias të Vjetër

Faqe 7




Tabela 6. Ranksimi i Bashkive të tjera që kanë njësi auditimi

Rankimi	Institucioni	Totali
Murzhi i Pikëve		
0 - 450		
1	Bashkia Kamëz	440
2	Bashkia Patos	425
3	Bashkia Vorë	415
4	Bashkia Memaliaj	395
5	Bashkia Krujë	385
6	Bashkia Dropull	380
6	Bashkia Skrapar	380
7	Bashkia Dëvjakë	370
7	Bashkia Gramsh	370
7	Bashkia Sarandë	370
8	Bashkia Lushnjë	360
9	Bashkia M. e Matit	355
9	Bashkia Ura Vajgurore	355
9	Bashkia Van Dejtë	355
10	Bashkia Fushë Arrës	350
11	Bashkia Mallq	345
11	Bashkia Pustec	345
12	Bashkia Libohovë	340
12	Bashkia Mat	340
13	Bashkia Bulqizë	335
14	Bashkia Librazhd	330
14	Bashkia Pogradec	330
15	Bashkia Finiq	325
15	Bashkia Himarë	325
16	Bashkia Mallakastër	320
17	Bashkia Rrogovë	315
17	Bashkia Tepelenë	315
18	Bashkia Kavajë	300
19	Bashkia Kolocë	295
20	Bashkia Devoll	290
21	Bashkia Kaçovë	280
22	Bashkia Shitak	230

Kamëz, "Buxheti i Bashkisë 2018", votë unanime të këshilltarëve të PS, LSI dhe PD, 65% shkon për investime

FAQE 2



Përmbytjet, Bashkia Kamëz, në ndihmë të qytetarëve të saj në çdo zonë

FAQE 4






Kamza, Bashkia me performancën më të mirë financiare sipas Ministrisë së Financave

Ministria e Financave ka vlerësuar bashkitë në vend për vitin e kaluar në lidhje me menaxhimin financiar, i cili u bazua në 15 kritere që matin këtë performancë, ku çdo kriter ka 30 pikë.

Kriteret e vlerësimit ishin: Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit; Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor; Numri i urdhër-shpenzimeve të refuzuara nga Thesari; Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar; Urdhër-prokurimet e paautorizuara; Mjedisi i kontrollit; Menaxhimi i riskut; Aktivitetet e kontrollit; Informimi dhe komunikimi; Monitorimi; Përgatitja e audituesve të brendshëm; Raportimi në kohë i audituesve; Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm; Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm; Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuar. Raporti përmbledhës i Financave tregon se nga një vlerësim 0-450 pikë, Bashkia e Kamzës mori vlerësimin më të lartë, me 440 pikë. “Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia e Kamzës është vlerësuar me 440 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të shkëlqyer të kësaj Bashkie dhe e renditur në vendin e parë”, - thuhet në raportin e Financave.

E dyta është Bashkia e Shkodrës (430 pikë), e ndjekur nga ajo e Patosit (425), e Vorës (415), më pas vijnë Durrësi (405 pikë), Elbasani (400 pikë), Memaliaj (395 pikë).

Bashkia e Tiranës, më e madhja në vend, u rendit e teta në radhën e bashkive për sa i përket pikësimit për treguesit e performancës, me 391 pikë. Bashkia e kryeqytetit e ka vlerësimin më të ulët në treguesin e menaxhimit të riskut, me 10 pikë, nga 30, që është vlerësimi maksimal dhe aktivitetet e kontrollit me 20 pikë, ndërsa



në treguesit e tjerë ka marrë përgjithësisht vlerësimin maksimal me 30 pikë. Financat theksojnë se gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm të Bashkisë Tiranë paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave kryesive, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut, i cili ka marrë vlerësim shumë të ulët në krahasim me të tjerët.

Në renditjen që kanë bërë financat vetëm për bashkitë e mëdha kryeson Shkodra, e ndjekur nga Durrësi, Korça, Elbasani dhe më pas renditet Tirana. Pas kryeqytetit vijnë Berati, Fieri, Vlora, Gjirokastra. Bashkitë e mëdha që janë edhe qendra të prefekturave, si ajo e Durrësit, Tiranës, Vlorës, Gjirokastrës dhe Kukësit kanë pësuar ulje të performancës më 2016 në raport me 2015, thekson raporti. Bashkitë që kanë arritur përmirësim janë Shkodra, Korça, Elbasani, Fieri dhe Berati. Bashkia e Shijakut dhe ajo e Tropojës morën vlerësimin më të ulët të performancës.

Vlerësimi i përgjithshëm për të gjitha bashkitë

Ministria e Financave analizon se treguesi “Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar”

Bashkia	Indikator	Vlerësim
1	Bashkia Kamzë	440
2	Bashkia Shkodër	430
3	Bashkia Patos	425
4	Bashkia Vorë	415
5	Bashkia Durrës	405
6	Bashkia Elbasan	400
7	Bashkia Memaliaj	395
8	Bashkia Tiranë	391
9	Bashkia Krujë	385
10	Bashkia Berat	385

për vitin 2016 nga bashkitë mesatarisht është vlerësuar me 21.1 pikë nga 30 pikë të mundshme ose ka një realizim prej 70.3%. Këto vlerësime tregojnë për një performancë të kënaqshme të këtij treguesi, ku pjesa më e madhe e bashkive janë vlerësuar me 25 dhe 30 pikë dhe vetëm një bashki është vlerësuar me 0 pikë. Pra, mund të konkludohet që bashkitë nuk kanë problematika të mëdha në dërgimin në kohë të faturave në thesar.

Vlerësimet më të mira bashkitë i kanë arritur në treguesin “Anulimi i kontratave gjatë një viti”, i cili ka një shkallë të lartë realizimi prej 92%, ku pikët mesatare të vlerësuar të këtij treguesi janë 27.6 pikë. Shumica e bashkive (51 prej tyre) kanë vlerësim maksimal të këtij indikatorit dhe asnjë bashki nuk është vlerësuar me 0 apo 5 pikë. Në përgjithësi, mund të themi që situata e këtij indikatorit në njësitë e qeverisjes vendore paraqitet në nivele shumë të kënaqshme.

Indikatorit tjetër i analizuar është “Urdhër-shpenzimet e refuzuara nga ana e Thesarit”. Pikët mesatare të marra nga bashkitë për këtë indikator janë 27.4 pikë, duke evidentuar një realizim prej 91.3%. Nga të gjitha

Raporti përmbledhës i Financave tregon se nga një vlerësim 0-450 pikë, Bashkia e Kamzës mori vlerësimin më të lartë, me 440 pikë. “Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia e Kamzës është vlerësuar me 440 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të shkëlqyer të kësaj Bashkie dhe e renditur në vendin e parë”, - thuhet në raportin e Financave

institucionet vendore, shumica prej tyre (45) është vlerësuar maksimalisht me 30 pikë dhe asnjë bashki nuk është vlerësuar me 0, 5 ose 10 pikë. Pra, situata e këtij indikatorit paraqitet në nivele shumë të kënaqshme.

“Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar” është një tjetër indikator i gjeneruar nga Drejtoria e Thesarit. Bashkitë, mesatarisht, janë vlerësuar me 19.2 pikë, ku ka 10 bashki të cilat janë vlerësuar me 0 dhe 5 pikë. Realizimi i këtij treguesi është 64%, duke evidentuar faktin që institucionet vendore, në shumicën e rasteve, arrijnë të dorëzojnë kontratat në thesar brenda afatit 3-ditor të caktuar.

Monitor

Kamzë, “Buxheti i Bashkisë 2018”, votë unanime të këshilltarëve të PS, LSI dhe PD, 65% shkon për investime



Është miratuar buxheti i Bashkisë Kamzë për vitin 2018. Me votën unanime të këshilltarëve tashmë i është dhënë drita jeshile e zbatimit një prej buxheteve më të mëdha të planifikuar, edhe pse trendi ka ardhur në rritje vit pas viti. Në buxhetin e vitit të ardhshëm pritet të financohen me dhjetëra e dhjetëra, mes tyre dhe superprojekte në infrastrukturë rrugore, si dhe do të ndërhyhet në KUN, do të ketë ndërhyrje në kolektorë, ujësjellës etj. Në fjalën e tij para këshilltarëve, kryebashkiaku i Kamzës, Xhelal Mziu, bëri një prezantim konkret të buxhetit, fokusin që do të ketë ai, si dhe garantoi që me zbatimin e tij Kamza dhe Paskuqani do të jenë me një infrastrukturë shumë më të mirë dhe të

standardeve bashkëkohore.

Zoti Mziu pranoi që ky buxhet është shqyrtuar me grupet e interesit si dhe me komunitetin për të qenë edhe ata të përfshirë, duke qenë se është në interes të tyre. Objektivi parësor i këtij buxheti do të jetë përmirësimi i infrastrukturës në të gjithë territorin e Bashkisë Kamzë dhe Njësisë Paskuqan, rritja e numrit të të punësuarve, zhvillimi ekonomik si dhe rritja e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve. Sipas kryetarit të Bashkisë Kamzë, z. Xhelal Mziu, ky është buxheti më i madh i përgatitur deri më tani, ku një pjesë të konsiderueshme e zënë të ardhurat vendore dhe kjo ka ardhur falë një pune të mirë të bërë në terren, luftës ndaj informalitetit

si dhe shtimit të numrit të biznesit. Kjo, falë lehtësirave që u krijon Bashkia si dhe komunikimit të mirë me biznesin. Zoti Mziu sërish shfaq pakënaqësinë me transfertën e pakushtëzuar nga qeveria që, sipas tij, nuk është ajo çfarë i takon Kamzës, pasi është me 10-15%. Tregues për këtë është edhe fakti po të bësh krahasimet me vitet e tjera, kur prej dy vitesh Kamza ka edhe Paskuqanin pjesë të saj. Zoti Mziu shtoi se edhe pse Bashkia Kamzë ka paraqitur 137 projekte në qeveri, asnjë financim nuk ka marrë. Përparësi të Bashkisë Kamzë në buxhetin e vitit 2018 janë: zhvillimi i harmonizuar i një ekonomie konkurruese në tregun rajonal, me biznese kryesisht të tregtisë, që zgjerohen e inkurajohen për të

Është votuar një prej buxheteve më të mëdha ndër vite. Parashikohen dhjetëra e dhjetëra projekte në infrastrukturë deri në rrugë me 16 metra gjerësi. Baza e financimit, të ardhurat vendore të Bashkisë.

pasur diversitet e cilësi; zhvillimi i ekuilibruar i territorit në përputhje me parametrat bashkëkohorë mjedisorë dhe urbanë, si dhe një jetë sociale cilësore, dinamike dhe gjithëpërfshirëse ku mundësitë individuale për progres dhe mirëqenie mbështeten e zgjerohen në mënyrë të barabartë. Buxheti i Bashkisë për vitin 2018 është 2,232,787 mijë lekë. Në mbyllje të fjalës së tij, z. Mziu garantoi që edhe projektet e vitit 2017 që janë në zbatim e sipër, do të mbyllen dhe ndër to përmendi qendrën e qytetit të Kamzës, pedonalen e qytetit, qendrën e Babrrusë etj.

Kryebashkiaku Xhelal Mziu për gazetën “Koha Jonë”: Rama të reflektojë për Kamzën

Dhjetor 2017
GAZETA KAMZA

3

Flet për “Koha Jonë”, kryetari i Bashkisë Kamëz, Xhelal Mziu: S’ka humbje në zgjedhjet e 2019, PS-në e pret disfata e radhës

Kryetari i Bashkisë Kamëz, Xhelal Mziu, në një intervistë për “Koha Jonë” ka deklaruar se Bashkia që ai drejton nuk ka marrë financat përkatëse nga qeveria për situatën e krijuar nga përmbytjet pak ditë më parë. Ai thekson se bashkëpunimi me qeverinë ka qenë thujtë zero që në fillim. “Qeveria ka braktisur Bashkinë me mbi 150 mijë banorë, duke mos e konsideruar fare. Në Bashkinë Kamëz nuk ka vetëm votues demokratë, por edhe socialistë dhe të bindjeve të tjera. Por, ne jemi diskriminuar politikisht dhe jo vetëm”, - është shprehur Mziu. I pyetur nëse do të jetë sërish kandidat për të katërtën herë në Bashkinë Kamëz, Mziu thotë se është ende herët për të folur, por shprehet i bindur se nëse kjo do të ndodhë, ai do t’i fitojë zgjedhjet.

Botuar në gazetën “Koha Jonë”, 15 dhjetor, 2017

Intervistoi: Jonida Halili

Z. Mziu, javët e fundit qytetarët e disa zonave të Kamzës u përballën me problemet e përmbytjeve. Çfarë po bëhet aktualisht për dëmshpërblimet e banorëve dhe cila ka qenë ndihma e qeverisë?

Që në fillim të kësaj interviste dua të theksoj se Kamza sivjet ka pasur përmbytje më pak se herët e tjera, pavarësisht prej reshjeve më të mëdha. Kjo ka ndodhur falë punës së bërë nga Bashkia në terren për pastrimin e kolektorëve. Jemi munduar që të bëjmë më të mirën, për faktin se qeveria, edhe pse na kaloi kompetencat, nuk i shoqëroi ato me financat përkatëse si dhe mjetet. Bashkisë Kamëz nuk iu dha asnjë mjet nga inventari i bordeve të kullimit, por për çudi edhe kur qeveria bleu 61 ekskavatorë dhe ua shpërndau bashkive, Kamzës nuk i akordoi asnjë. Numri i familjeve të përmbytura nga reshjet e fillimuarit dhjetor ka shkuar në 697, prej të cilave 230 janë me dëme më të mëdha. Grupet e punës së shtabit të emergjencave të Bashkisë Kamëz kanë bërë evidentimin në terren, duke verifikuar çdo dëm. Sa u përket dëmshpërblimeve, ende nuk është bërë asgjë, madje qytetarët që janë përmbytur, nuk kanë marrë dëmshpërblimet as të viteve të tjera. Në terren po bëhet një punë e mirë nga Bashkia, ku po punohet me dy turne dhe situata është normalizuar. Në bashkëpunim me shoqata, por edhe prefekturën, kemi shpërndarë ndihma në ushqime tek familjet. Bashkia ndërkohë do të akordojë një ndihmë financiare për të përmbyturit.

Gjatë ditëve të përmbytjeve pati një takim mes jush dhe Kryeministrit Edi Rama që u komentua gjatë në media. Duke pasur parasysh akuzat e ashpra që keni shkëmbyer shpesh me Edi Ramën për çështje politike, cilat kanë qenë reagimet e demokratëve dhe drejtuesve të PD-së për këtë takim?

Sa i përket takimit me Kryeministrin, dua të theksoj se bashkëpunimi im nuk ka munguar asnjëherë. Bashkëpunim nuk quhet vetëm takimi fizik, e sidomos në atë rast emergjence, por edhe ai institucional. Unë, si kryetar i Bashkisë Kamëz, i kam dërguar me dhjetëra e dhjetëra shkresa Kryeministrit dhe qeverisë bashkëngjitur me projekte konkrete, duke kërkuar mbështetje financiare. Janë mbi 137 projekte që flenë në sirtarët e kabinetit “Rama” dhe asnjë përgjigje nuk kemi marrë. A nuk është kjo absurde, ku Bashkia e gjashtë më e madhe në vend nuk gjen mbështetjen e ekzekutivit?! E nëse unë kam akuzuar për mosbashkëpunim, kam thënë vetëm të vërtetën, duke mos prodhuar politikë dhe këtë e kam bërë në interes të qytetarëve të Kamzës që i kam primarë, të cilët më kanë besuar prej vitit 2007. Unë nuk kam ngrirë asnjëherë në marrëdhënie institucionale me qeverinë, por shpresoj të shkrijë qeveria. Fakti që unë i kam kërkuar qeverisë financim të projekteve në rrugë zyrtare, kam besuar se do të gjeja mbështetje. Deri tani nuk ka ndodhur, shpresoj që të reflektohet. Në atë takim të shkurtër me Ramën, veç kërkesës për dëmshpërblimin e familjeve të përmbytura, i parashtrova si kërkesa emergjente edhe financimin e kolektorëve: Valias i Ri, Valias i Vjetër, të kolektorit Zall-Herr – Bathore – Frutikulturë, pajisja me ekskavator, gjë që i ishte mohuar Bashkisë më parë nga ana e qeverisë si dhe pajisja e Kamzës me një stacion zjarrfikëseje, duke qenë se nuk e kemi, edhe pse ndodhet në Kodër-Kamëz. Takimi me Kryeministrin ka qenë në kuadër të bashkëpunimit institucional, duke qenë se jam kryetar i Bashkisë së gjashtë më të madhe në vend dhe jo si kreu i degës së PD Kamëz, si dhe në kushtet e emergjencës kur qindra shtëpi ishin nën ujë.

Kamzës, realisht, nuk i kanë munguar investimet nga qeverisja e PD-së. Kur tashmë e majta është në pushtet prej disa vitesh, çfarë investimesh kanë ardhur në Kamëz gjatë kësaj periudhe?



Flet për “Koha Jonë”, kryetari i Bashkisë Kamëz, Xhelal Mziu: S’ka humbje në zgjedhjet e 2019, PS e pret disfata e radhës

Qeveria “Berisha” e ka mbështetur Kamzën, duke financuar mjaft projekte në fusha të ndryshme, por e kundërta ka ndodhur me qeverinë “Rama”. Duke qenë se si kryetar Bashkie më është dashur të jem në detyrë në dy kohë, para dhe pas vitit 2013, me dy kryeministra, të PD-së dhe PS-së, dua të theksoj se Kryeministri Berisha ishte krejt ndryshe. Homologët e mi, përfaqësues të PS-së, gjenin bashkëpunim tek z. Berisha (këtë ma pohonin), i cili, pasi i dëgjonte, merrte projekte zhvilluese prej tyre në dobi të komunitetit, ua financonte. Kryeministri Berisha dhe qeveria e tij nuk i shihnte bashkitë politikisht, por prioritarë kishin qytetarët. Më duhet të konstatoj që prej vitit 2013, me Kryeministër Edi Ramën, Kamzës i është rikonstruktuar vetëm një qendër shëndetësore, përkundër variantit që kishim ne si Bashki ta çonim në një tjetër ambient shumë më të madh, tek ish-shkolla profesionale. Pra, konstatohet qartë që kjo qeveri ka braktisur Bashkinë me mbi 150 mijë banorë, duke mos e konsideruar fare.

Lidhur me investimet në pushtetin vendor me ndihmën e qeverisë, Kryeministri ka deklaruar se bashkitë e djathta nuk kanë sjellë projekte dhe kjo është arsyeja pse nuk kanë përfituar. Mendoni se ka diskriminim politik për çështjen e fondeve?

Bashkëpunimi i qeverisë me Bashkinë Kamëz ka qenë zero dhe kjo jo për fajin tim si kryebashkiak. Kur më sipër theksova se mua nuk më ka munguar bashkëpunimi institucional, kam parasysh faktin se, përkundër pretendimit të Kryeministrit, ne si Bashki kemi çuar mbi 137 projekte, të cilat nuk kanë gjetur mbështetje dhe flenë në sirtarët e qeverisë. Qeveria e ka detyrim të mbështesë bashkitë dhe ato nuk duhen parë me syrin politik. Sikurse Kryeministri edhe ne kemi marrë votën qytetare. Në Bashkinë Kamëz nuk ka vetëm votues demokratë, por edhe socialistë dhe të bindjeve të tjera. Për t’u përgjigjur pyetjes suaj, dua të them që po, jemi diskriminuar politikisht dhe jo vetëm madje!

Na e përshkruani rolin tuaj brenda Partisë Demokratike të Shqipërisë ose, më saktë, nëse ju do ta kishit humbur

Bashkinë e Kamzës në 2007-ën, mendoni se kjo do të kishte efekt negativ brenda partisë?

Unë, përveç kryetar i Bashkisë Kamëz, jam edhe kreu i degës lokale të PD-së. Kam qenë në këtë pozicion prej vitit 2005 dhe vazhdoj të drejtoj degën e partisë pas besimit absolut të anëtarësisë dhe strukturave. Sigurisht që, nëse unë do të kisha humbur zgjedhjet lokale të vitit 2007 për kryetar Bashkie, do të kisha përgjegjësi, jo vetëm për faktin se isha kandidat dhe drejtues i partisë, por do të humbisja edhe në një zonë bastion. Kjo nuk ka ndodhur deri më tani dhe nuk ka për të ndodhur.

A mund të na bëni një bilanc të punës suaj në 3 mandate në krye të Bashkisë Kamëz?

Kamza ka pësuar ndryshime rrënjësore e ndoshta do të duhen faqe të tëra gazete për të numëruar arritjet ose projektet e realizuara. Krahasuar me vitin 2007, kur u ula në karrigen e kryebashkiakut, realiteti është krejt ndryshe. Jemi ndër qytetet e para që miratuar planit urbanistik, qyteti i vetëm me sistem të plotë adresash ku kemi emërtuar mbi 505 rrugë dhe Kamza është gati për implementimin e ZIP-KOD-it. Janë asfaltuar me qindra e qindra km rrugë, janë shtrirë me qindra rrjet të ujësjellës-kanalizimeve, duke përmirësuar ndjeshëm furnizimin me ujë të pijshëm. U mundësua mbyllja e fazës së parë të projektit të ujësjellës-kanalizimeve nga banka gjermane KfW dhe së shpejti fillon zbatimimi i fazave të tjera. Mbi 70% e popullsisë kanë rrjet të ri ujësjellësi dhe furnizim me ujë. Kemi mundësuar edhe shtrirjen e rrjetit të furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike 20 kv mbi 70% të popullsisë.

Janë ndërtuar 18 objekte shkollorë (shkolla dhe kopshte) me standarde evropiane. Bashkia ka ndërtuar Pallatin modern të Kulturës për të rinjtë dhe të gjithë qytetarët, një nga më të mirët në vend. U ndërtua stadiumi i qytetit si dhe palestra moderne e basketbollit në Bathore. Kemi ngritur qendrën e shërbimeve ndaj qytetarëve, One Stop Shop, më e mira në Shqipëri, e vlerësuar nga ndërkombëtarët si praktika më e mirë e qeverisjes vendore. Është 4-fishuar numri i bizneseve, falë taksave të ulëta dhe klimës së mirë që kemi krijuar, gjë që na ka mundësuar edhe punësimin e mijëra qytetarëve. Bashkia Kamëz ka pasur një paketë fiskale konkurruese dhe stimuluese për zhvillimin e biznesit, gjë që ka çuar në rritjen e numrit të të punësuarve me mbi 10 mijë veta, ku një ndihmë ka dhënë sektori fason.

Të ardhurat e Bashkisë janë mbi 10-fishuar krahasuar me vite më parë. Kamza sot është një qytet i pastër, me makineri pastrimi bashkëkohore dhe kontejnerë të standardeve evropiane. Mundësuar shtrirjen e linjës së telefonisë fikse dhe internetit në gjithë territorin e Kamzës, ndërtuar rrugën “Demokracia” 7 km të gjatë nga Ura e Institutit në Babrru deri tek Kafja e Rremës etj. Të tjera projekte janë në zbatim jo vetëm për ndërtimin e qindra km rrugë dhe KUN, por dhe qendra e qytetit të Kamzës bashkë me pedonalen, rehabilitimi i qendrës së Babrrusë etj.

Do të kopjoni Ramën për të kandiduar për të katërtën herë për Bashkinë apo do të sfidoni Erion Veliajn për Bashkinë e Tiranës?

Nuk kam lidhje me asnjërin. Sa i përket kandidimit, është herët ende për ta diskutuar, pasi jam në krye të detyrës, i votëbesuar në mënyrë plebishitare nga bashkëqytetarët prej vitit 2007. Në kohën e duhur, në konsultim me qytetarët, anëtarësinë, strukturat e degës dhe drejtuesit e PD-së, do të shprehem.

Nëse i humbisni zgjedhjet në 2019-ën, keni menduar të hiqni dorë nga politika?

Nuk ka shanse të humb zgjedhjet në vitin 2019. Partia Demokratike në Kamëz ka marrë rezultat plebishitar, duke fituar sa herë ka pasur zgjedhje. Kjo ndodhi edhe në zgjedhjet e vitit 2017, ku rezultati i PD-së vetëm sa u thellua. Partinë Socialiste sërish e pret humbja e radhës në Kamëz.



Bashkia Kamëz, në ndihmë të qytetarëve të saj në çdo zonë

Gjatë përmbytjeve, 24 orë në krye të detyrës, Bashkia: Ndërsa Shqipëria përmbytet, Rama krihet dhe prodhon politikë

Shqipëria është përmbytur dhe ndodhet nën ujë, por Kryeministri dhe qeveria e tij nuk ishin të interesuar për situatën, por të prodhonin politikë. Në mes të natës, në reagimin e qeverisë për dy bashki të djathta (mes tyre edhe Kamza), Rama "krihet" dhe as kishte ndërmend të ishte në mbështetje të qytetarëve. Paturpësia është se në vend që qeveria të reagojë si duhet ndaj situatës ku përmbytje kishte: në autostradën Tiranë-Durrës, Fushë-Krujë, Mamurras, Vlorë, Fier, Gjirokastrë, Korçë etj. dhe një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ishte pa energji, qindra e mijëra banorë donin ndihmën e ekzekutivit, Rama tentonte të rrekej për të prodhuar politikë, duke përmendur bashkitë e djathta e ndërkohë sulmonte edhe Kamzën. I kujtojmë Ramës dhe qeverisë së tij se përkundër mosmbështetjes qeveritare, Bashkia e Kamzës brenda mundësive të saj kishte nisur punën për t'u paraprirë situatave të tilla, ku prej kohësh kishte nisur pastrimin i kolektorit më të madh në Kamëz, ai i Valiasit, mbi 1 km, i cili nuk ishte pastruar në 27 vjet si dhe kolektorëve të tjerë. I kujtojmë Ramës se propaganda nuk mbulon aspak neglizhencën e qeverisë së tij, e cila nuk ka mbështetur aspak pushtetin vendor me financime dhe mjete për situata emergjente.

Bashkia Kamëz ka qenë dhe është në krye të detyrës dhe nuk ka aspak nevojë për apelin e një Kryeministri në gjumë, që alarmohet sa herë vijnë reshjet apo bien zjarre.

Pjesa më e madhe e stafit të Bashkisë Kamëz dhe ndërmarrjeve në vartësi ishin në terren në ndihmë të qytetarëve dhe evidentimit të nevojave të tyre.

I kujtojmë Ramës që, në vend të retorikës, të angazhohet seriozisht në terren në mbështetje të Bashkisë Kamëz dhe qytetarëve që kjo situatë të kalojë me sa më pak pasoja.

Rama nuk ka aspak të drejtë të bëjë apel apo të



Situata në terren deri në orën 11:00 të ditës së përmbytjeve

Pjesa më e madhe e stafit të Bashkisë, ndërmarrjeve etj. ishte 24 orë në terren për menaxhimin e situatës së paprecedentë të reshjeve të shiut dhe të përmbytjeve në territorin e Bashkisë.

Situata ishte shumë e rëndë në disa lagje të Bashkisë, si: Valias, Frutikulturë, Laknas, Bathore, Kamëz, Paskuqan 1, Paskuqan 2, Kamëz, Fushë-Kërçik etj.

Falë angazhimit të grupeve të punës në terren pati 15 familje të evakuara:

Valias i ri, 3 familje
Frutikulturë, 1 familje
Laknas, 3 familje
Bathore, 5 familje
Paskuqan, 3 familje.

Bashkia Kamëz, duke qenë me mbi 150 mijë banorë, por edhe zonë me rrezik të lartë nga: lumi Tirana; lumi Tërkuçë; lumi Lana nuk mundet që pushteti vendor, Bashkia, t'i japë zgjidhje asaj as në aspektin afatgjatë dhe as afatshkurtër, për shkak të trashëgimisë së saj nga ish-NB në qytet me dendësinë e popullsisë më të madhe në vend. Bashkia e Kamzës vazhdon të shihet me syrin e njerks dhe të persekutohet në vazhdimësi nga qeveria "Rama". Janë paraqitur mbi 137 projekte në qeveri dhe asnjëri prej tyre nuk është financuar.

Kemi paraqitur projekte për:

Kolektorin kryesor të Bathores
Kolektorin kryesor të Frutikulturës
Kolektorin kryesor të Valiasit të ri

137 projekte flenë në sirtarët e qeverisë, mes tyre edhe për kolektorët. Është skandaloze fakti që qeveria me ndarjen e re territoriale nuk i kaloi kompetencat e Bashkisë shoqëruar me fondet dhe mjetet përkatëse. Bleu 61 ekskavatorë dhe ua shpërndau bashkive, Kamzës nuk i dha asnjë. Kamzës nuk iu dha repart zjarrfikëseje dhe as zjarrfikëse, megjithëse ndodhej në Kodër-Kamëz.

shtetërore. Nuk iu dha asnjë ekskavator Kamëz (i mori Bashkia Tiranë) nga 61 ekskavatorët e blerë nga qeveria "Rama".



akuzojë për faktin sepse Kamzën e ka parë me sy politik, e ka diskriminuar me mosakordim fondesh në çdo fushë, pavarësisht projekteve që Bashkia ka dorëzuar dhe ato vazhdojnë të flenë në sirtarët e qeverisë.

Më konkretisht, me ndarjen e re territoriale Kamzës nuk iu akordua fondi financiar për pastrimin e kolektorëve dhe paturpësisht edhe kur qeveria e Ramës bleu 61 ekskavatorë dhe i shpërndau në një ceremoni propagandistike, Kamzës nuk iu dha asnjë. Si duket, qytetarët e këtij vendi i interesojnë Ramës vetëm në kohë zgjedhjesh, por në Kamëz atë e kanë kuptuar shumë mirë dhe e çojnë nga humbja në humbje dërrmuese.

Kishte përmbytje edhe në disa familje në:

Valias, mbi 30 familje
Frutikulturë, mbi 26 familje
Bathore, mbi 17 familje
Kamza, 16 familje
Paskuqan, 23 familje
Laknas, 22 familje.

Bashkia Kamëz vendosi në dispozicion të zgjidhjes së situatës afatgjatë si investimin e disa segmenteve (kolektorëve të hapur), të cilat bëjnë përmbytjet duke bërë investimin me të ardhurat e Bashkisë si vendosja e tubave nga fi 100 dhe fi 2000 apo kosom, apo pastrim të tyre.

Kolektorin kryesor të Valiasit të Vjetër
Kolektorë të tjerë në Fushë-Kërçik
Kolektorë të tjerë në Babrru-Shpat
Kolektorë të tjerë në Paskuqan 1
Kolektorë të tjerë në Paskuqan 2 etj.

Për asnjë nga këta kolektorë Bashkia Kamëz nuk gjeti mbështetjen e qeverisë për t'i financuar.

Sa i përket delegimit të kompetencave me ndarjen e re territoriale për disa funksione të reja sërish Bashkia Kamëz u persekutua, si:

A-Për kanalet kulluese dhe vaditëse

Nuk u dha asnjë mjet nga ish-ndërmarrjet

B-Repartet zjarrfikëse (ishte një në Kodër-Kamëz, por Kamzën e persekutuan dhe ia kanë lënë Tiranës)

Pra, Kamza ka zero reparte zjarrfikëse, zero mjete. Qeveria delegoi kompetencat, por jo repartet dhe mjetet.

C-Mirëmbajtja e rrugëve rurale, rajonale etj.

Qeveria nuk dha asnjë qindarkë financim ku janë mbi 1210 km rrugë gjithsej dhe me dhjetëra km rrugë rajonale dhe kombëtare, duke shkaktuar paqartësi dhe më pak buxhet për Bashkinë për funksionet e tjera.

Kryebashkiaku Xhelal Mziu së bashku me kryetarin e PD-së, Lulzim Basha vizituan familjet e përmbytura në Kamëz

Dhjetor 2017
GAZETA KAMZA

5



Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, u takua me disa prej familjeve të përmbytura në Bashkinë e Kamzës, ku zonat më problematike ishin Valiasi, Frutikultura, Lalnasi dhe një pjesë e Bathores. Kryebashkiaku i Kamzës, Xhelal Mziu, i tha Bashës se institucioni që drejton ka arritur të nxjerrë nga rreziku më shumë se 250 familje, ndërsa u ankua se nuk ka pasur mbështetjen e pushtetit qendror. Kryedemokrati Lulzim Basha vizitoi disa prej zonave më të prekura nga përmbytjet në Bashkinë e Kamzës. Kryebashkiaku Mziu i tregoi Bashës arsyen përse, sipas tij, u regjistruan përmbytje edhe në Kamëz. Porosia e Bashës ishte që t'i jepej prioritet absolut shpëtimit të jetëve të njerëzve, ndërsa rekomandoi qytetarët që t'i përgjigjen thirrjes për evakuim.

Ndërkaq, në rrjetin social "Facebook" Basha shkruante: "U takova me familjet e përmbytura në Bashkinë e Kamzës. Dëmet janë të mëdha. Kryebashkiaku Mziu është pa mbështetjen e autoriteteve, por ia ka dalë të ndihmojë mbi 250 familje të rrezikuara. Banorët më treguan se u përmbytën për shkak të shkarkimit të liqenit të Bovillës pa u paralajmëruar. Inkurajova kryebashkiakun Xhelal Mziu të bëjë gjithçka për t'u ardhur në ndihmë banorëve me mjetet që ka në dispozicion. Zoti Mziu më tha se ekskavatorin që i takonte me vendim qeverie, ia ka marrë Bashkia e Tiranës. Deri tani, në zonë ka shkuar vetëm një makinë ushtrie për 11 persona në rrezik. Megjithatë, i kërkova zotit Mziu dhe banorëve që takova, që të kenë prioritet evakuimin e qytetarëve".



Mziu me Emergjencat Civile të Bashkisë: Evidentoni çdo dëm tek qytetarët, prioritet jetët njerëzore

207 familje të përmbytura me dëme të raportuara nga grupet e punës të EC Bashkia Kamëz deri në orën 20:00 të ditës së përmbytjeve, ndërsa vazhdojnë verifikimet në terren

Pas një pune intensive në terren 24 orësh, prej mbrëmjes së të enjtes në orët e pasdites së të premtes 1 dhjetor, kryetari i Bashkisë së Kamzës ka mbledhur grupet e punës të Emergjencave Civile për të raportuar për punën e kryer.

Në këtë takim në fillim të fjalës së tij kryebashkiaku Xhelal Mziu falënderoi stafin e Bashkisë dhe të ndërmarrjeve vartëse për punën e mirë të bërë, gjë të cilën ai e kishte konstatuar në takimet që me qytetarët në territorin e Bashkisë, si dhe në takimin me kreun e PD-së, Lulzim Basha. Në komunikimin me drejtuesit dhe anëtarët e Shtabit të Emergjencave Civile në Bashki, z. Mziu kërkoi në mënyrë të prerë të bënin më të mirën në detyrën e tyre, të ushtronin me përgjegjshmëri detyrat e ngarkuara dhe prioritet absolut i tyre të ishte ndihma për qytetarët dhe veçanërisht shpëtimi i jetëve njerëzore.

Kryebashkiaku Xhelal Mziu kërkoi nga grupet e punës që të shkonin shtëpi më shtëpi, të trokisnin derë më derë dhe të evidentonin çdo dëm sado minimal të shkaktuar tek qytetarët.

"Kërkoj impenjim maksimal të gjithsecilit prej jush, që evidentimi i dëmeve të bëhet deri në orët e vonë të mbrëmjes, teksa do të bëjmë mbledhjen tjetër të shtabit ku do të raportoni", - tha z. Mziu në mbledhjen e EC.

Kryebashkiaku Xhelal Mziu kërkoi që pas evidentimit të



dëmeve, vlerësimit financiar të tyre, të kalohej për vendim në Këshillin Bashkiak, më pas në Prefekturë dhe të çohet lista tek Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, me qëllim dëshmipërbllimin sa më shpejt të banorëve.

Kryetari Mziu kërkoi nga administrata që të evidentohej çdo nevojë emergjente në terren dhe Bashkia t'u vijë në ndihmë banorëve brenda mundësive të saj. Zoti Mziu kërkoi partneritet me privatët në këtë rast si dhe bashkëpunim me institucionet për të pastruar zonën ku për shembull: mjetet që vijnë nga bordi i kullimit të punonin edhe me dy turne ku Bashkia do të kontribuonte edhe financiarisht, mjafton që zona të pastrohej dhe qytetarëve t'u kthehej normaliteti.

Z. Mziu premtoi se Bashkia do të shikonte mundësinë që

familjeve të përmbytura t'u akordohej edhe ndihmë financiare brenda mundësive. Në fund të fjalës, kryebashkiaku i Kamzës, Xhelal Mziu, kërkoi nga Shtabi i Emergjencave Civile që deri në orët e vona të mbrëmjes të kenë shkuar në çdo shtëpi, ku të kenë evidentuar çdo dëm për secilën familje të përmbytur.

Deri në orën 20:00 të mbrëmjes së premte, ishin 207 familje të përmbytura me dëme të raportuara nga grupet e punës të EC, Bashkia Kamëz.

Paskuqan 18 familje
Bathore 72 familje
Kamza 38 familje
Valiasi i Ri 53 familje
Frutikultura 26 familje.



Kryebashkiaku Mziu për "Tonight": Në Kamëz u përmytën 635 familje, situata do përsëritet, nëse qeveria nuk financon projektet

Kryetari i Bashkisë së Kamzës, z. Xhelal Mziu, ishte i ftuar në emisionin "Tonight" të gazetares Ilva Tare në "Ora News". Në "Tonight" ai foli rreth përmytjeve që ndodhën në territorin e Bashkisë së Kamzës, duke bërë një rezumë të të gjithë situatës.

Në fillim të intervistës kryebashkiaku Mziu u shpreh: "Aktualisht, situata është më e mirë sesa 2-3 ditë më parë. Kemi një situatë tashmë që është konstatuar në çdo familje. Kemi një situatë, e cila nuk është përsëritur asnjëherë në këto përmasa në këto vite në Bashkinë e Kamzës. Nga verifikimet që kemi bërë në terren nga të gjitha grupet e punës konstatohet që kemi numër të konsiderueshëm prej 635 familjesh, të cilave realisht u është futur uji brenda në familje në lartësi deri në 2 metra lartësi".

Bëhet fjalë nga ujërat që vijnë nga shirat apo nga kanalizimet e ujërave të zeza që kanë shpërthyer?

Është uji që vinte, për shkak të shiut dhe për shkak të kolektorëve të hapur që janë brenda zonës urbane dhe në këto 635 shtëpi më shumë sesa 150 familje nuk banojnë në shtëpitë e tyre, por kanë shkuar tek të afërmit e tyre, çka do të thotë që pavarësisht se është përmirësuar situata shtëpitë e tyre, janë akoma të pabanueshme. Besoj se kjo ishte një situatë e cila ka qenë e pranishme edhe viteve të tjera. Të mos harrojmë që zona e Kamzës është një zonë, e cila ka qenë e gjitha rurale, një ndërmarrje bujqësore. Sot Kamza ka më shumë sesa 140 mijë banorë, duke qenë Bashkia e 6-të në Shqipëri për nga numri i popullsisë, çka do të thotë që ka nevojë për ta ndryshuar infrastrukturën e saj, nga kanalet e ujërave për kullim dhe vaditje, për ta kthyer në zonë urbane. Kamza ka edhe një disfavor se të dyja anët e saj laget nga lumi i Tiranës dhe i Tërkuzes.

Nga familjet e përmytura, ka nga ato që janë të paligjshme të ndërtaura pa leje?

Besoj që e gjithë zona e Kamzës në vitin 1990 ka pasur vetëm 10 mijë banorë, ndërsa sot ka më shumë sesa 140 mijë banorë, çfarë do të thotë 14 apo 15 herë më shumë kanë ardhur nga zonat veriore apo lindore të Shqipërisë; çfarë do të thotë që janë ndërtime të cilat janë ndërtaur në këto 15 vitet e fundit. Shumica e këtyre familjeve edhe janë përmytur dhe mund të them që Bashkia e Kamzës është bashkia që ka dendësinë e popullsisë më të madhe në 61 bashkitë e Shqipërisë. Ka dy pika rreziku për shkak të pozicionit gjeografik që ajo ka, një pjesë në Valiasin e Ri, e cila ishte edhe epiqendra kryesore e përmytjeve, që



ishin më shumë se sa 240 familje dhe pjesa e Frutikuturës. Të dyja këto pika rreziku janë dy kolektorët kryesorë shkarkues në lumin Tiranë, të cilët e kishin të pamundur përballimin e reshjeve të shiut. Besoj se në zonën e Kamzës ka ndikuar, përveç reshjeve të shiut, mosfinancimi i këtyre dy projekteve të cilët në mënyrë koherente ka vite për të cilët i kërkoj financimin e tyre, pasi Bashkia e ka të pamundur për të bërë financime kapitale, sepse Bashkia më shumë sesa 40% e buxhetit të saj në çdo vit e dërgon për kolektorë kullues dhe vaditës.

Ke nevojë aktualisht? Si po menaxhohet situata? Familjet kanë ndihmë apo kontribut nga ju? Si është situata? Ke nevojë për diçka që të duhet nga administrata qendrore apo po e përballojnë?

Dëmi i shkaktuar, jo vetëm në Kamëz, po kudo në Shqipëri, por edhe dëmi që i shkaktohet shtetit për rehabilitimin tyre, është shumë herë më i madh sesa investimi, sidomos në argjinaturat e lumenjve, por edhe në kolektorët kryesorë. Situata konkrete e Kamzës është një situatë e cila ka të bëjë me më shumë sesa 600 familje, shtëpitë e të cilave janë bërë vërtet të pabanueshme, që do t'u kushtojë shumë atyre, jo vetëm nga ana ekonomike, por edhe në aspektin social, por besoj që do t'i kushtojë edhe buxhetit të Bashkisë edhe buxhetit të shtetit. Kanë qenë të vazhdueshme kërkesat që ne kemi bërë si institucion i Bashkisë ndaj qeverisjes qendrore dhe mund të them që kemi dërguar me dhjetëra projekte, por dy nga projektet kryesore kanë qenë këto ku ndodhën përmytjet, me epiqendrë në Valias dhe me epiqendrë në Frutikuturë. Dua të them që të gjitha ujërat që grumbullohen janë jo vetëm ujërat e Bashkisë së Kamzës, por edhe të Bashkisë së

Tiranës, siç është ish-komuna e Zall-Herrit dhe është e pamundur për t'i përballuar me buxhetin e Bashkisë. Kemi kërkuar në mënyrë koherente financimin e këtyre dy projekteve, por ndërkohë u tha në studio që janë blerë 61 ekskavatorë; janë ndarë makineritë e ish-ndërmarrjeve komunale ose të Bordit të Kullimit dhe dua të them që ka pasur edhe selektime, madje edhe selektime politike. Bie fjala, Bashkia e Kamzës është një ndër ato bashki që nuk ka përfituar asnjë mjet nga inventari i këtyre ish-drejtorive. Nga 61 ekskavatorët që janë shpërndarë, nuk ka marrë Bashkia e Kamzës asnjë ekskavator, por nuk kemi marrë edhe financimin e tyre. Duhet një tjetër frymëmarje që duhet t'u jepet këtyre bashkive, sidomos në drejtim të investimeve kapitale, siç janë, për shembull, kullimet që krijojnë një kosto të jashtëzakonshme për qytetarët, por njëherazi edhe për qeverinë.

Zoti Mziu, ju pamë me Ramën, në takimin që Kryeministri zhvilloi me ju. Dukeshit mjaft miqësor dhe bashkëpunues në atë takim. Patët mundësi t'ia thoshit këto shqetësime?

Parandalimi i përmytjeve, Xhelal Mziu: Ja kërkesat që i parashtrua Ramës



Kryebashkiaku Xhelal Mziu teksa ishte prej 36 orësh në terren pranë familjeve të përmytura në Valias dhe zona të tjera të Kamzës dhe Paskuqanit, shoqëroi Kryeministrin Rama gjatë vizitës në zonën e përmytur si dhe i parashtrou kreut të qeverisë kërkesat që kishte institucioni i Bashkisë.

Ndryshe nga herët e tjera përmes shkresave,

Ishte një vizitë shumë e shkurtër, 15 minuta, dhe në këto 15 minuta unë gjatë gjithë kohës i tregova situatën në të cilën ndodhet Kamza, koherencën e dërgimit të projekteve në mënyrë të vazhdueshme dhe i kërkoja financimin e këtyre dy projekteve, të cilat janë të papërbalueshme nga buxheti i Bashkisë dhe ndërkohë për të pasur edhe mbështetje financiare për ekskavator apo për reparat zjarrfikësesh. Dua të them se në Tiranë janë 3 reparte zjarrfikësesh dhe reparti që mbulonte zonën e Kamzës dhe Paskuqanit, sot administrohet nga Bashkia e Tiranës dhe është vërtet një rast unik që në vitin 2017 apo në fillim të vitit 2018, ne nuk kemi reparat zjarrfikësesh, nuk kemi asnjë makineri për pastrimin e kolektorëve apo të kanaleve kulluese dhe vaditëse. Besoj se ky duhet të jetë një sinjal për buxhetin e shtetit 2018 apo për delegim fondesh për të financuar në këto projekte strategjike për të mos pasur më situata të tilla, pasi e njëjta situatë, por në situata pak më të vogla, është përsëritur edhe në vitin 2015. Jam i bindur që nëse nuk ndodh financimi, do të kemi përsëri situata të tjera të përmytjeve.

kryebashkiaku Mziu i kërkoi "live" Ramës që të financonte disa projekte emergjente që do të ndihmonin në parandalimin e përmytjeve.

Duke ecur në këmbë dhe duke parë nga afër situatën e rënduar në të cilën ndodhej Valias, zoti Mziu i kërkoi Kryeministrin:

1. Dëmshtëpërlimin e rreth 400 familjeve të përmytura në Kamëz që kanë pësuar dëme në shtëpitë e tyre, të konstatuara këto, nga grupet e punës të Shtabit të Emergjencave të Bashkisë Kamëz.
2. Financim të kolektorëve: Valias i Ri, Valias i Vjetër.
3. Financim i kolektorit Zall-Herr-Bathore-Frutikuturë.
4. Pajisja me ekskavator, gjë që i ishte mohuar më parë nga ana e qeverisë.
5. Pajisja e Kamzës me një stacion zjarrfikëseje, duke qenë se nuk e ka.

Kryebashkiaku Mziu takim me prefekten e Tiranës znj. Suzana Jahollari në kuadrin e bashkëpunimit



Kryetari i Bashkisë së Kamzës, z. Xhelal Mziu, ka pritur në takim prefekten e Qarkut të Tiranës, znj. Suzana Jahollari, në kuadrin e bashkëpunimit, për shkak të situatës së përmytjeve që ndodhën në Kamëz. Takimi i tyre kishte si fokus situatën pas përmytjeve, rikuperimi dhe stabilizimi i situatës së përmytjeve.

Mziu e falënderoi prefekten për ardhjen në takim dhe për angazhimin dhe sensibilizimin e saj për përmytjet që ndodhën në Kamëz. Në këtë takim, z. Mziu tha që praktikisht ishte kaluar kjo situatë të vështirë, por nuk është zgjidhur akoma plotësisht, sepse edhe kur ranë disa reshje shiu më pas, u përmytën edhe disa familje të tjera në Frutikuturë,

pavarësisht ndërhyrjes së vazhdueshme të Bashkisë Kamëz në pastrimin e kolektorëve për t'u ardhur në ndihmë banorëve të kësaj zone. Kështu që, problematikë thelbësore dhe shqetësuese mbeten dy KUN-të, në Valias dhe Frutikuturë, prandaj kryebashkiaku Mziu kërkoi mbështetjen edhe të prefektes znj. Suzana Jahollari për financimin e këtyre dy KUN-ve, investimi i të cilave do t'u jepte zgjidhje përfundimtare përmytjeve në Kamëz. Sivjet kanë ndodhur më shumë përmytje, ndërsa Bashkia Kamëz ka bërë pastrimin e kolektorëve, të gjitha me fondet e veta, si dhe ka ndërhyrë në kushte emergjente me fondin rezervë për të qenë sa më pranë tyre, për t'u ardhur në ndihmë këtyre familjeve. Prefektja e qarkut të Tiranës, znj. Jahollari, i garantoj kryebashkiakut Mziu që do të bëjë të pamundurën që kjo situatë të zgjidhet për t'u ardhur në ndihmë familjeve të përmytura dhe që në Kamëz të mos ndodhin më përmytje, duke e mbështetur Bashkinë në këto dy projekte strategjike KUN në Valias dhe Frutikuturë. Ndërkohë, prefektja në bashkëpunim me Bashkinë shpërndanë ndihma për 22 familje, ndërsa në total kishin ardhur ndihma për mbi 100 familje u shpërndanë ditën e nesërme.

Punë intensive e Bashkisë së Kamzës 24 orë në terren për situatën e reshjeve



Kryebashkiaku Mziu ka qenë në terren, duke ndjekur nga afër lirin e hapësirave publike që janë ndërtaur mbi kolektor në Paskuqan 2. Kjo ndërhyrje ka qenë emergjente, pasi ka ndikuar në përmytjet të kësaj zone. Ka vijuar puna edhe për pastrimin e kolektorit kryesor në Frutikuturë. Kjo është një tjetër masë që ka marrë Bashkia Kamëz për situatën e reshjeve. Puna intensive e Bashkisë Kamëz ka vazhduar edhe në kolektorin kryesor në Frutikuturë, 1100 ml, financim i Bashkisë Kamëz. Po kështu, edhe për pastrimin e kolektorit kryesor nga lumi Tiranë - Rinas - Valias i Vjetër - Valias i ri - Vëllezërit Lleshi - lumi Tiranë, financim i Bashkisë Kamëz me



fondet e veta. Ndërkaq, Bashkia Kamëz ka vijuar punën në terren për hapjen e rrugës mbi kolektorin në Paskuqan 2, Fushë. Nga afër në terren punimet i ka ndjekur vetë kryebashkiaku Xhelal Mziu. Mbi këtë kolektor do të ndërtohet një rrugë, me gjatësi 430 ml, me të gjithë parametrat dhe ndodhet në kufirin ndarës me Njësinë Laprakë të Tiranës. Nuk do të ketë më përmytje në këtë zonë. Investimi do të realizohet me fondet e Bashkisë Kamëz. Kryebashkiaku Xhelal Mziu ka inspektuar në terren gjithashtu edhe punimet për pastrimin e kolektorit kryesor në Valias, financim i Bashkisë Kamëz me fondet e veta. Punimet vijojnë me ritme të shpejta.



Bashkëpunim i Bashkisë Kamëz me fondacione dhe organizma të ndryshëm për të qenë sa më pranë qytetarëve

Ka qenë i frytshëm bashkëpunimi i Bashkisë Kamëz me fondacione dhe organizma të ndryshëm për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve të saj që janë prekur nga përmbytjet. Bashkia vijon të qëndrojë pranë banorëve të saj. Në këtë kuadër janë shpërndarë ndihma ushqimore dhe batanije për familjet të cilave shtëpitë u janë përmbytur. Dy kanë qenë pikat më të prekura nga përmbytjet, zona e Valiasit dhe e Frutikuturës. Shpërndarja e ndihmave ushqimore dhe batanijeve është bërë në bashkëpunim edhe me grupet e punës që Bashkia ka në terren për identifikimin e të gjithë familjeve të dëmtuara.



Takim me drejtorin e shoqatës "Gjysmëhëna e Kuqe" nga Emiraret e Bashkuara Arabe



Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, ka vijuar takimet me fondacione të ndryshme për t'u ardhur në ndihmë familjeve të përmbytura në Kamëz. Në takim qe pati me drejtorin e shoqatës "Gjysmëhëna e Kuqe", nga Emiraret e Bashkuara Arabe, z. Hamad Ben Abdennabi, kryebashkiaku Mziu i bëri një përmbledhje të situatës së përmbytjeve në Kamëz dhe i tregoi edhe dy pikat më të rrezikshme që kanë ndodhur përmbytjet me epiqendër Valiasin dhe Frutikuturën. Në Kamëz nga verifikimet janë konstatuar mbi 635 familje të përmbytura. Z. Mziu e konsideroi privilegj ardhjen e tyre në Bashkinë Kamëz, duke u shprehur mirënjohje dhe u tregua i gatshëm për të bashkëpunuar në zbutjen e situatës në Kamëz, por edhe në fusha të ndryshme. Edhe presidenti i fondacionit u tregua i gatshëm për bashkëpunim në fusha të ndryshme. Fondacioni "Gjysmëhëna e Kuqe" para disa vitesh ndërtoi qendrën shëndetësore në Valias.

Kryebashkiaku Xhelal Mziu, takim me drejtorin e fondacionit "Mirësia" z. Korab Kaja



Kryebashkiaku Xhelal Mziu zhvilloi takim me drejtorin e fondacionit "Mirësia" z. Korab Kaja. Në këtë takim Mziu falënderoi drejtorin e fondacionit për gatishmërinë e këtij fondacioni për t'u ardhur në ndihmë familjeve të përmbytura në Kamëz. Ky fondacion ka shpërndarë ndihma ushqimore dhe batanije për 200 familje të prekura nga përmbytjet. Ndërkohë u shprehën të gatshme që familjeve më të prekura nga përmbytjet do t'i ndihmojnë më shumë sesa këto ndihma ushqimore dhe batanije.

Takim me drejtoren e Kryqit të Kuq për Tiranën, znj. Xhuljeta Muçollari



Kryebashkiaku i Kamzës, z. Xhelal Mziu, priti në një takim drejtoren e Kryqit të Kuq për Tiranën, znj. Xhuljeta Muçollari, e cila kishte shprehur gatishmërinë e saj për t'u ardhur në ndihmë familjeve që u prekën nga përmbytjet. Bashkëbisedimi u përqendrua te këto familje në nevojë, por të dy u shprehën të gatshëm për të vijuar këtë bashkëpunim jo vetëm në këtë drejtim. Kryebashkiaku Mziu e falënderoi drejtoren e Kryqit të Kuq për Tiranën për sensibilizimin që ka treguar për familjet e përmbytura dhe tha që ky moment le të shërbejë jo vetëm në kuadrin e ndihmave për familjet në nevojë, por për të vijuar edhe me bashkëpunime të tjera.

Edhe znj. Muçollari e përgëzoi Mziun për menaxhimin e mirë që i ka bërë situatës së përmbytjeve dhe i tha që përveçse do t'i ndihmojë këto familje në nevojë, do të ofrojë edhe kurse rrobaqepësie 3-mujore falas në Kamëz, ku në përfundimin të kursit do të pajisen me certifikatë. Gjatë bashkëbisedimit u diskutua edhe hapja e një dege të Kryqit të Kuq në Kamëz dhe për këtë do të vijë në Bashkinë Kamëz edhe presidenti i Kryqit të Kuq Shqiptar.

Ndihma për familjet e prekura nga përmbytjet në Valias dhe Frutikuturë

Përveç bashkëpunimeve me fondacione dhe shoqata të ndryshme, Bashkia Kamëz ka bashkëpunuar edhe me prefekturën. Kështu, janë shpërndarë në total 100 pako për 100 familje të prekura nga përmbytjet. Kjo ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit dhe takimit të kryebashkiakut Xhelal Mziu me prefektën Suzana Jahollari. Ndërkohë, në bashkëpunim me një grup të Bashkisë Kamëz znj. Jahollari ka shkuar vetë në disa familje në Valias, ku kanë shpërndarë ndihma për këto familje. Bashkia Kamëz vijon t'i mbështesë këto familje që janë prekur nga përmbytjet.

Kjo është një nismë e Bashkisë për të qenë sa më pranë banorëve të saj. Tjetër nismë shumë e rëndësishme e Bashkisë Kamëz është edhe puna intensive për pastrimin e kolektorëve në Valias dhe Frutikuturë, të gjitha me fondet e veta si dhe ka ndërhyrë në kushte emergjente me fondin rezervë për të ndihmuar banorët e saj. Të gjitha punimet i ka ndjekur nga terreni vetë kryebashkiaku Xhelal Mziu.

Takim me zv.drejtorin e shkollës "Turgut Ozal" në kuadrin e bashkëpunimit



Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, priti në një takim zv.drejtorin e shkollës "Turgut Ozal". Takimi i tyre kishte si fokus bashkëpunimin midis Bashkisë dhe kësaj shkolle për t'u ardhur në ndihmë familjeve që janë prekur nga përmbytjet në Kamëz. Gjatë bashkëbisedimit të tyre kryebashkiaku Mziu i bëri me dije numrin e familjeve të përmbytura si dhe i tregoi edhe dy nga zonat më të prekura nga përmbytjet, zona e Frutikuturës dhe e Valiasit. Për këtë shkolla "Turgut Ozal" është sensibilizuar për të qenë sa më pranë këtyre familjeve. Menjëherë pas takimit mes tyre, një grup i Bashkisë së bashku me disa nxënës të shkollës "Turgut Ozal" kanë shpërndarë pako me ndihma për 48 familje në zonën e Frutikuturës.

Bashkëpunim me Ambasadën Turke në ndihmë të familjeve në Valias të Vjetër

Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Ambasadën Turke kanë shpërndarë pako me ndihma për familjet e prekura nga përmbytjet në zonën e Valiasit të Vjetër. Në mbështetje të këtyre familjeve të dëmtuara nga përmbytjet dhe në vështirësi ekonomike e sociale janë shpërndarë 200 pako me ndihma. Edhe ditë të tjera, për shkak të bashkëpunimit të Bashkisë me shoqata dhe fondacione të ndryshme janë shpërndarë ndihma për banorët e Frutikuturës. Pra, ka vijuar bashkëpunimi i Bashkisë Kamëz për t'u ardhur në ndihmë banorëve të saj që u prekën nga përmbytjet disa ditë më parë.



Xhelal Mziu: Shoqata “Jetimi në fokusin tonë” dhe shumë shoqata të tjera na kanë ofruar bashkëpunim

Kryetari i Bashkisë Kamëz z. Xhelal Mziu, i pranishëm në aktivitetin e shoqatës “Jetimi në fokusin tonë”, është shprehur që shoqata e zotit Hysen Dosti dhe shumë shoqata të tjera gjatë ditëve të përmbytjeve kanë ardhur për të bashkëpunuar me Bashkinë, për t’u ardhur në ndihmë familjeve të prekura nga përmbytjet. Përveç sensibilizimit të kësaj shoqate për familjet në nevojë, zoti Mziu e nderoi me certifikatë mirënjohje dhe shprehu gatishmërinë e tij që të bashkëpunojnë edhe në fusha të tjera. Edhe zoti Dosti u tregua i gatshëm që të bashkëpunojë me Bashkinë. Ndërkohë, në përfundim të këtij aktiviteti, në bashkëpunim midis Bashkisë dhe shoqatës u shpërndanë pako me veshmbathje dhe ushqimore për 70 familje në nevojë dhe për fëmijët jetimë. Ndër të tjera, kryebashkiaku Mziu gjatë aktivitetit tha: “Është një kënaqësi për mua të më jepet rasti, për shkak të bashkëpunimit të shkëlqyer që ne kemi pasur me presidentin e shoqatës “Jetimi



në fokusin tonë”, Hysen Dosti. Kjo shoqatë e cila edhe më parë ka bashkëpunuar me ne për t’u ardhur në ndihmë këtyre

familjeve dhe gjatë kontaktit që pata me presidentin më ofroi edhe bashkëpunime të tjera për t’u ardhur në ndihmë familjeve në nevojë, pse jo, edhe fëmijëve që duan të ndjekin kurse anglishte apo për situatën në të cilën po kalon Kamza apo Shqipëria, për shkak të përmbytjeve. Shoqata e zotit Dosti, por edhe shoqata të tjera janë sensibilizuar, kanë ardhur kanë bashkëpunuar me Bashkinë dhe po ndikojnë në amortizimin e problemeve të shkaktuara nga përmbytjet e javës së fundit. Mua s’më mbetet gjë tjetër, por në emrin tuaj, të të gjithë përfituesve, ta falënderoj presidentin dhe t’i ofroj edhe një herë bashkëpunimin e vazhdueshëm që do të ketë me Bashkinë në të gjithë sektorët që ajo mund të gjejë mundësi bashkëpunimi”.

Shoqata “Jetimi në fokusin tonë” së bashku me Bashkinë Kamëz kanë bërë aktmarrëveshje bashkëpunimi midis tyre prej 3 vitesh. Kjo shoqatë ka 5 vite që është themeluar.

Kryebashkiaku Mziu, takim me përfaqësues të KfW për fillimin e fazës 3-4 të ujësjellësit të Kamzës

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, priti përfaqësuesin e KfW-së, z. Uwe Moshage, dhe koordinatoren e projekteve të huaja në AKUK, z. Jovan Gjika.

Gjatë takimit u diskutua për ecurinë e fazave të tjera të projektit të ujësjellës-kanalizimeve në qytetin e Kamzës si dhe ranë dakord për një zgjidhje fizibël, e cila ishte një nga kërkesat e parashtruara nga kryebashkiaku Mziu edhe në takimet e tjera që janë zhvilluar.

Gjithashtu, z. Mziu e vuri theksin tek shtrirja e investimit edhe në disa zona të tjera periferike si dhe tek dy KUN-të që ndodhen në zonën e Valiasit dhe Frutikuturës.

Investimi të këto dy KUN është shumë i rëndësishëm, pasi si rezultat i tyre ndodhën edhe përmbytjet në këto dy zona. Drejtoi i projektit, z. Uwe Moshage, bëri një panoramë të qartë të zonave ku do të shtrihet projekti dhe vuri në dukje që përfitues të fazës së 3-4 do të jenë më shumë se 40 mijë banorë.

Kryesisht do të ndërhyhet në zgjerim të zonave të shërbimit dhe në linjat e transmetimit që e kanë të domosdoshme ndërhyrjen. Gjithashtu, një pikë shumë e rëndësishme e diskutimit mes kryebashkiakut Mziu dhe përfaqësuesve të KfW ishte edhe financimi nga KfW i zyrave të reja që do të jenë me standarde bashkëkohore.



Vijon puna e Bashkisë për lirim e hapësirave publike për të ndërtuar rrugë në dobi të komunitetit



Vijon puna e Bashkisë Kamëz për lirim e hapësirave publike për të ndërtuar më pas rrugë në dobi të komunitetit. Prishjet kanë ndodhur përgjatë rrugës “Arben Broci” në lagjen Paskuqan 2. Në këtë zonë së shpejti do të ndërtohet rruga “Anton Zogaj”, që është një tjetër investim i Bashkisë i mundësuar tërësisht nga të ardhurat e veta. Tashmë kanë kaluar dy vite qëkur Paskuqani i është bashkuar Bashkisë së Kamzës. Ajo që ka qenë më shumë se e nevojshme në këtë njësi administrative është ndërtimi i infrastrukturës rrugore dhe të kanalizimeve. Kjo ka qenë edhe një nga kërkesat më emergjente të qytetarëve të kësaj zone, gjithashtu një premtim i kryebashkiakut Xhelal Mziu gjatës fushatës elektorale të vitit 2015, tashmë i bërë realitet. E në të vërtetë, jo vetëm qytetarët e Paskuqanit, por edhe ata që kalojnë aty, i vërejnë ndryshimet rrënjësore që kanë ndodhur në këto dy vite. Janë me dhjetëra projekte bashkëkohore të përqendruara kryesisht në infrastrukturën rrugore dhe të ujësjellës-kanalizimeve që janë realizuar e po realizohen ditë pas dite në Njësinë Administrative të Paskuqanit. Megjithatë, këto investime do të vijojnë edhe në vitin 2018. Një prej tyre është edhe rruga “Anton Zogaj”.

Pallati i Kulturës Kamëz, veprimtari të shumta edhe në muajin dhjetor

Ashtu si edhe çdo vit tjetër, Pallati i Kulturës Kamëz për 2017-ën pati një kalendar të ngjeshur me veprimtari të shumta dhe të larmishme. Mes gjerdanit të artë të këtyre veprimtarive spikat konkursi botëror i bukurisë “Miss Globe 2017”. Ndërkaq, të tjera ngjarje kulturore gjatë këtij viti ishin: ekspozitë e piktorëve të vegjël, veprimtari për Ditën e Poezisë, promovime librash, organizime për të rinj, veprimtari përkujtimore për data e ngjarje historike, koncerti i shoqatës “Kaltërsia”, koncerti i shkollës “Kol Jakova”, Festivali Multikulturor Kamza 2017, veprimtari për Ditën Botërore të Autizmit, veprimtari të shoqërisë “Ardhmëria”, pjesëmarrja në festivalin “Burimet e Sharrit” në Tetovë, recitali i Eglantina Babqorrit, veprimtari për dasmën shqiptare, mbrëmje poetike, konkursi i fjalës artistike, “Jetimët në fokusin tonë”, veprimtari e grave, ceremoni e qeverisë së nxënësve në bashkëpunim me ZAK, panairi i etnografisë etj.

Ndërkaq, gjatë muajit dhjetor pjesë e veprimtarive të Pallatit të Kulturës do të jetë edhe një pjesë teatrale nga aktorja e mirënjohur Marjana Kondi, festivali i shkollave të mesme, koncerti i shkollës “Elina”, koncerti i kopshtit “Pikolino”, koncerti i shoqatës “Kaltërsia”, si dhe veprimtari në kuadër të Vitit të Ri.

Politikat favorizuese të Bashkisë, kompania Euroasia Footwear ofron 250 vende pune në Kamëz

Vijon bashkëpunimi i Bashkisë Kamëz dhe i kryebashkiakut Xhelal Mziu me kompani të ndryshme për të qenë sa më pranë qytetarëve të saj. Kompania Euroasia Footwear sh.p.k kërkon të punësojë pranë saj 250 punëtorë nga qyteti i Kamzës.

Kjo është një politikë favorizuese e Bashkisë për t’u ardhur në ndihmë qytetarëve të saj. Në kuadrin e kësaj, kryebashkiaku Mziu zhvilloi një takim me një prej drejtuesve të kësaj kompanie, ku u ra dakord për bashkëpunim në dobi të banorëve të Kamzës. Aktualisht, pranë kësaj kompanie janë të punuar 730 punonjës.



Bashkia Kamëz dhe kryebashkiaku Xhelal Mziu kanë ofruar gjithnjë bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët e rëndësishëm në jetën e qytetit të Kamzës për të dhënë kontributin e tyre në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës qytetare dhe kulturore. Bashkia, nëpërmjet instrumenteve të saj, po zhvillon të gjitha politikat mbështetëse, duke u ofruar kushte dhe infrastrukturë të përshatshme, siç është edhe Pallati i Kulturës.

Euroasia Footwear sh.p.k, kompani që merret me merret me prodhimin e këpucëve, është e interesuar të punësojë 250 punëtorë në proceset e prodhimit të këpucëve për departamentet e prerjes së lëkurës, qepjes, montimit etj.

Kompania ofron për të interesuarit një kurs njëmuor të paguar. Edhe transporti për punëtorët është i garantuar falas.

Të interesuarit i ftojme të kontaktojnë me telefon në numrat +355 67 604 4195 dhe +355 67 604 4174 ose të paraqiten pranë fabrikave të kompanisë, në dy adresa:

- 1-Rruga “Gjergj Balshaj” ish-Praktiker
- 2-Bulevardi Blu (përballë Shpresa-AL) Kamëz.